Nr. protokolli: _____

Data: _____

SHKOLLA FILLORE KOMUNALE

“SAID NAJDENI” – DIBËR

RAPORT PËR PUNËN
EDUKATIVO-ARSIMORE NË FUND TË VITIT SHKOLLOR

2025/2026

DIBËR, GUSHT 2026

Përmbajtja:

1.1 Letërnjoftimi i shkollës

1.2 Kushtet hapësinore për punën e shkollës

1.3 Struktura organizative e shkollës

1.4 Kuadri arsimor dhe jo arsimor

1.5 Shkalla arsimore e të punësuarve

2.1 Procesi edukativo-arsimor në Sh.F.K. "Said Najdeni" – Dibër

2.2 Seminare dhe trajnime

2.3 Institucioni ynë arsimor përveç realizimit të plan-programeve mësimore obligative realizon edhe aktivitete jashtë mësimore me nxënës

2.4 Donatorët që kontribuan gjatë vitit shkollor 2025/2026

2.5 Aspekti infrastrukturor dhe mirëmbajtja e objektit shkollor

3.1 Analizë e rezultateve dhe suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor 2025/2026 në shkollën tonë

3.2 Analizë e pasqyrave statistikore që lidhen me suksesin e nxënësve, rregullshmërinë, notat mesatare sipas lëndëve etj, të cilat janë paraqitur me grafikone/tabela por edhe me sqarime të shkurtra

1.1 Letërnjoftimi i shkollës:

Emri i shkollës	**SH.F.K. "Said Najdeni"**
Adresa, Komuna, Vendi	**Rr. "Ice Risteski" pn., Dibër, Dibër**
Tel/Fax dhe Celular	**046-831-641 / 070-325-029**
E-mail:	**saidnajdeni@yahoo.com**
Ueb faqe	**www.saidnajdeni.edu.mk**
Facebook	**SHFK "Said Najdeni" Dibër**
E themeluar me datë	**01.04.1999**
Numri i Aktit të Verifikimit	**10-1577/3**
Viti/data e Verifikimit	**05.07.1999**
Gjuha në të cilën realizohet mësimi	**Gjuhë shqipe**
Viti i ndërtimit të shkollës	**1985**
Tipi i ndërtimit	**Me material të fortë**
Sipërfaqja e objektit	**2149 m2**
Sipërfaqja e oborrit të shkollës	**19 144 m2**
Sipërfaqja e tereneve sportive	**1351 m2**
Organizimi i mësimit	**Në 2 turne**
Mënyra e ngrohjes së shkollës	**Nxemje qëndrore me naftë**
Numri i klasëve	**Klasët nga I deri IX -të**
Numri i paraleleve	**36 paralele**

1.2 Kushtet hapësinore për punën e shkollës

Numri i përgjithshëm i objekteve	**3**
Oborri i shkollës	**19144 m2**
Numri i shkollave periferike	**Nuk ka**
Sipërfaqja totale	**22182 m2**
Sipërfaqja neto	**2149 m2**
Numri i tereneve sportive	**2**
Numri i kateve	**2**
Numri i kabineteve	**20**
Numri i hapësirave ndihmëse	**10**
Biblioteka e shkollës	**1**
Kushtet materiale teknike	**Shkolla i plotëson në mënyrë optimale kushtet materiale teknike për punë dhe për procesin mësimor me nxënës.**


Р. СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА · R. E MAQEDONISË SË VERIUT
ООУ „САИД НАЈДЕНИ“ – ДЕБАР
SH.F.K. "SAID NAJDENI" – DIBËR
Palestra

1.3 Struktura organizative e shkollës

Numri i anëtarëve të Këshillit shkollor	7 – Kryetar Lumi Croj
Numri i anëtarëve të Këshillit të Prindërve	36 - Kryetar Lulzim Aziri
Aktivet profesionale	Aktivi i gjuhëve (Kryetare-Jehona Pekmezi) Aktivi i shkencave natyrore (Kryetar-Miron Mulladauti) dhe Aktivi i lëndëve të shkathtësive (Kryetar-Rilind Koleci). Aktivet e ciklit te ulet sipas gjeneratave.
Këshillat e klasave	Organizimi i këshillave të klasave bëhet përmes 9 këshillave sipas klasave dhe mësimdhënësit ku jep mësim.
Anëtarë të bashkësisë së nxënësve të Shkollës	Bashkësia e nxënësve të shkollës është e organizuar me një kryesi prej 5 nxënësish e zgjedhur nga vetë nxënësit dhe Parlamenti i nxenesve.

1.4 Kuadri arsimor dhe jo arsimor

Numri i të punësuarve (kudari arsimor dhe joarsimor)	76
Numri i kuadrit arsimor	58
Numri i bashkëpunëtorve professional	3
Punëtor administrative	1-sekretar/1-arkëtar
Shërbimi teknik	11
Drejtor	1 – Arsim Miftari
Ndihmës drejtor	1 – Mirdita Duka

1.5 Shkalla arsimore e të punësuarve

Përgatitja arsimore	Numri
Arsim sipëror (VII/1) – fakultet	51
Përgatitje profesionale e lartë (VI/1) – shkollë e Lartë	13
Arsim i mesëm	2
Përgatitje tjetër arsimore	11



Lokacioni në Google maps: Kërko- Shkolla Fillore Komunale Said Najdeni-Dibër
FACEBOOK : **Sh.F.K"Said Najdeni"Dibër**
Ueb: **www.saidnajdeni.edu.mk**

Arritja tek lokacioni i shkollës për ata që vijnë me vetura dhe për këmbësorët. Gjatë udhëtimit mund të orientohen edhe me tabela të vendosura tek rruga kryesore që të çon për në pikën



kufitare Bllatë.

Sipas ligjit për arsimin fillor dhe sipas kalendarit të MASH-it, mësimi i rregullt për vitin shkollor 2025-2026 filloi në datën 01.09.2025. Ekipi drejtues i Sh.F.K. "Said Najdeni"-Dibër i realizoi të gjitha parapërgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, gjithmonë duke u bazuar në standardet, protokollet dhe normat ligjore në fuqi.

Gjatë vitit shkollor 2025/2026, procesi edukativo-arsimor realizohet në pajtim me Kalendarin për organizim dhe punën e shkollave, sipas programit mësimor në pajtim me Planin mësimor për vitin shkollor 2025/2026. Mësimi në prani fizike realizohet për nxënësit nga klasa e I (parë) deri në klasën e IX (nëntë), sipas rekomandimeve të MASH.

Paraprakisht është punuar shumë që gjithçka të ishte gati për fillimin e vitit të ri shkollor. Kështu, gjatë pushimeve verore stafi teknik dhe higjieniko-sanitar i përgatiti hapësirat e shkollës si dhe ato ndihmëse përreth. Kabinetet/klasat, salla sportive, zyrat dhe poligoni ishin të gatshme si nga ana teknike, ashtu edhe nga ajo higjienike për fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026. Rëndësi e posaçme iu kushtua kushteve për realizimin e mësimit në përputhje me Planin dhe Protokollin për të siguruar një proces edukativo-arsimor të vazhdueshëm, duke respektuar masat për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve dhe prindërve.

2.1 Procesi edukativo-arsimor në Sh.F.K. "Said Najdeni" – Dibër

Siç edhe dihet, në shkollën "Said Najdeni"-Dibër, mësimi realizohet në gjuhën shqipe, prej klasës së I -rë deri në të IX-tën. Ai zhvillohet në dy ndërrime, respektivisht paradite dhe pasdite dhe procesin edukativo-arsimor e zhvillojnë plot 59 (pesëdhjetë e nëntë) arsimtarë.

Realizimi i procesit edukativo-arsimor për këtë vit shkollor bëhet në pajtim me Kalendarin për organizim dhe punën e shkollave, sipas programit mësimor në pajtim me Planin mësimor për vitin shkollor 2025/2026, me prani fizike për nxënësit nga klasa I-IX.

Fillimi i vitit shkollor 2025/2026 e gjeti shkollën me programet pedagogjike dhe profesionale të realizuara nga udhëheqësia e shkollës dhe kuadri arsimor, të plotësuara edhe me ndihmën e sociologut, pedagogut dhe psikologut të shkollës. Kurrikulat janë hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajnë metodën dhe procedurën adekuate për arritjen e parimeve dhe qëllimeve edukativo-arsimore të secilës lëndë. Po ashtu, përmbajnë temat mësimore, metodën dhe mënyrën e realizimit të planifikuar paraprakisht.

Sa i përket programit mësimor, ai është përpiluar në përputhje me Ligjin, duke përmbajtur të gjitha objektivat e përcaktuara nga BZHA. Këtë vit shkollor sipas rekomandimeve programi i përpunuar nga mësimdhënësit ashtu që të plotësohen të gjitha kërkesat, qëllimet e nxënies dhe nevojat e nxënësve për një vit shkollor të suksesshëm duke marrë parasysh rrethanat dhe kushtet gjatë kësaj periudhe.

Në fillim të vitit kalendarik 2026 (janar 2026), nga komisioni i shkollës u realizua inventarizimi i pasurisë së shkollës për vitin kalendarik 2025. Komisioni azhurnoi listat e fletëngarkesave për pasurinë e shkollës si dhe dorëzoi raport të shkurtër për gjendjen e inventarit të shkollës, ku theksohen cilat resurse janë në gjendje pune dhe cilat duhet të zëvendësohen në periudhën e ardhshme. Drejtoria bën përpjekje që pasuria e shkollës të mbrohet sa më shumë me qëllim të përdorimit afatgjatë të saj.

Aktivet profesionale të shkollës janë po ashtu shumë të angazhuar për realizimin e planit që kanë dorëzuar. Ata mbajnë takime të rregullta ku secili diskuton për realizimin e planit mësimor, procesin edukativ, arritjet e nxënësve, zgjidhjen e problematikave potenciale etj.Gjithashtu, aktivet planifikojnë aktivitetet dhe mënyrat e realizimit të tyre në të arrdhmen. Ata

bashkëpunojnë ngushtë me njëri tjetrin, me qëllim të shkëmbimit të ideve dhe përvojave. Secila mbledhje shënohet në procesverbal nga ana e Kryetarit të Aktivit.

Prindërit (qytetarët) kanë pasur jo vetëm lajmërime publike, por edhe ftesa individuale për çdo prind (familje) të regjionit që të gravitojnë pranë shkollës sonë, për të regjistruar fëmijët e tyre këtu. Për këtë është kujdesur ekipi drejtues i Sh.F.K. "Said Najdeni" – Dibër.
I njëjti njoftim u bë edhe në ueb faqen e shkollës www.saidnajdeni.edu.mk dhe në faqen e shkollës, në rrjetin social facebook, ku u mundësua që të gjithë prindët të mund të shkarkojnë "FORMULARIN_PËR REGJISTRIM NE PDF FORMAT", duke e lehtësuar në këtë mënyrë procedurën e regjistrimit të fëmijëve të tyre.

Raport mbi respektimin e ndarjes regjionale për vitin shkollor 2025/2026

Gjatë këtij viti shkollor, ndryshe nga pritshmëritë dhe në kundërshtim me vendimet paraprake, një pjesë e prindërve nuk respektuan ndarjen regjionale. Edhe pse Autoritetet Komunale dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), në bashkëpunim me shkollën, ndërmorën masat e nevojshme për zbatimin e saj, fenomeni i mosrespektimit vazhdoi të jetë prezent.

Ashtu si edhe vitin e kaluar, çështja e regjistrimit të nxënësve u trajtua si problematikë në nivel komunal. Për këtë arsye, u thirrën në takim drejtorët e shkollave përkatëse si dhe Inspektori i Arsimit. Në këtë takim u vendos që të vazhdohet me të njëjtin nivel serioziteti në zbatimin e vendimeve si në vitin shkollor paraprak.

Sipas Vendimit të Këshillit Komunal, nga viti shkollor 2023/24, të gjithë nxënësit që janë regjistruar padrejtësisht në shkolla të tjera, në kundërshtim me ndarjen regjionale, duhet të rikthehen në shkollën "Said Najdeni". Gjithashtu, është ndaluar vazhdimi i këtij fenomeni në të ardhmen.

Sa i përket pajisjes me tekste shkollore, ky proces u realizua falas për të gjitha klasat, prej kasës së I-rë deri në të IX-të, U evidentuan vonesa me furnizimin e librave nga ana e MASH-it. Edhe pse menaxhmenti i shkollës vazhdimisht përsërit kërkesën për libra, në disa lëndë ata vazhdojnë të mungojnë.

Në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2025/2026 u realizuan me sukses plan-programet mësimore. Gjithashtu, për arsye të ndryshimit në plan-programeve në disa lëndë drejtoria u angazhua për pajisjen e nxënësve me kopje të materialeve. Për disa materiale mësimore nxënësit u orientuan që të njejtat t'i gjejnë në web faqen e MASH-it
e-ucebnici.mon.gov.mk në formë digjitale. Si pjesë e parapërgatitjeve për fillimin e vitit shkollor 2025/2026 ishte edhe mbledhja me Këshillin e arsimtarëve të të dy cikleve, ku u bë ndarja e orëve dhe caktimi i kujdestarëve të klasave (nga klasa e I-rë deri në klasën e IX-të). Gjithashtu u prezantua Raporti vjetor i vitit shkollor paraprak, si dhe u diskutua për aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren gjatë vitit shkollor 2025/2026, me synim të posaçëm mbarëvajtjen e një viti më të suksesshëm në procesin edukativo-arsimor.

Deri në fillim të muajit dhjetor, drejtoria u mundësoi disa nxënësve që kishin nevojë për pajisje teknologjike, të kenë tablet që edhe ata të kyqen në mësimin online ndërsa u siguruan Tabletë për nxënësit e klasëve të me qëllim që të kenë qasje në librat digjital sipas konceptit të ri për arsim fillor.Aktiviteti do të vazhdojë edhe gjatë gjysmëvjetorit të dytë që të mos hasim në vështirësi për kyqje të nxënësve në platformat për të siguruar librat digjital.

Bashkëpunimi mes palëve të përfshira në process ndihmon shumë në rritjen e këtij efikasiteti, prandaj SHFK "Said Najdeni-Dibër" i kushton rëndësi të veçantë komunikimit dhe bashkëpunimit me prindërit. Mënyra kryesore mbetet komunikimi verbal por, secili prind dhe qytetar i interesuar mund të ketë qasje në lidhje me lajmërimet, njoftimet, udhëzimet nëpërmjet postës elektronike, faqen zyrtare në Facebook: Sh.F.K. "Said Najdeni" Dibër dhe ueb faqen: www.saidnajdeni.edu.mk . Rritja e komunikimit me prindërit dhe transparenca janë objektiva kryesore të shkollës për të arritur një efikasitet më të madh të procesit edukativo- arsimor.

E gjitha kjo bëhet me qëllimin e qartë që shkolla dhe procesi mësimor të jenë në hap me kohën. Rëndësi e posaçme i kushtohet përdorimit të TIK-ut gjatë mësimdhënies, mënyrës aktive dhe interaktive të zhvillimit të procesit mësimor, përdorimit të mjeteve didaktike, digjitale dhe softuerëve mësimor me qëllim të demonstrimit dhe lidhjes së praktikës me teorinë. Të vetëdijshëm se pjesa dërrmuese e rezultatit dhe suksesit të procesit edukativo- arsimor varet nga niveli profesional i mësimdhënësve, ekipi drejtues i shkollës vazhdimisht obligon mësimdhënësit për vetëvlerësimin e punës së tyre. Bashkëpunimi dhe puna në ekip kanë një peshë të veçantë, pasi aty dalin në pah sfidat, inkurajimi dhe motivimi i arsimtarëve.

Të gjitha monitorimet direkte evidentohen në "Formularin për përcjellje të orës mësimore". Përmes kësaj mbikqyrjeje u identifikuan pikat e forta dhe dobësitë e punës së arsimtarëve, çka u pasua edhe me këshilla profesionale për përmirësimin e punës me nxënës. Gjatë vitit 2025/2026, drejtoria dhe shërbimi profesional (pedagog, sociolog dhe psikolog) mbikëqyri realizimin e planit edukativo-arsimor, duke monitoruar orët drejtëpërsëdrejti tek arsimtarët sipas një plani të caktuar paraprakisht në Programin vjetor të shkollës në lëndët e tyre respektive në të dy ciklet. Aktiviteti do të vazhdojë edhe gjatë gjysëmvjetorit të dytë 2025/2026.

Në muajin nëntor u mbajtën mbledhjet me prindër me prani fizike në nivel shkolle, gjatë të cilave u vërejt se pjesëmarrja e prindërve ishte në nivelin e duhur. Në fillim të vitit shkollor 2025/2026 kujdestarët e klasëve të VI-ta mbajtën mbledhje me prindër, gjatë të cilave u bë prezantimi kujdestar-prind, njohja me rendin shtëpiak si dhe me lëndët e reja mësimore dhe mbarvajtjen e mësimit sipas rekomandimeve nga MASH dhe BZHA.

Gjatë këtyre mbledhjeve,theks i veçantë iu dha aspektit edukativ të nxënësve, sjelljes dhe suksesit të nxënësve. Mbledhja me prindër u pasua nga mbledhja e Këshillit të Arsimtarëve, thirrur nga drejtoria e shkollës. Prioritet i kësaj mbledhje ishte analiza e mbledhjeve me prindër, me theks të posaçëm marrja parasysh e kërkesave dhe ankesave të prindërve për të përmisuar punën e përgjithshme edukativo-arsimore për gjysmëvjetorin e dytë 2025/2026.

Këtë vit shkollor sipas Ligjit për arsim fillor dhe rekomandimeve të MASH në bashkëpunim me Qendrën për resurse-Manastir u angazhua 1 asistent arsimor (Sonila Osmani) që do të punojë me nxënësin me nevoja të veçanta SH.F.K. "Said Najdeni" një vëmendje të posaçme i kushton edhe punës me nxënësit me nevoja të veçanta, të cilët i integron brenda procesit edukativo- arsimor. Në një bashkëpunim të ngushtë mes Këshillit të prindërve, sociologut dhe arsimtarëve u hartuan listat e nxënësve me vështirësi në mësime. Poashtu, u planifikuan aktivitetet që kanë në fokus socializimin e nxënësve të kësaj kategorie. Angazhimi i asistentit-arsimor ndikoi pozitivisht tek nxënësit me nevoja të veçanta si dhe tek prindërt e tyre. Të njejtët dorëzojnë raport për gjysmëvjetorin e parë 2025/2026 për punën e tyre në shkollë.

SH.F.K. “Said Najdeni”- Dibër në kontinuitet bashkëpunon me të gjthë institucionet që lidhen me arsimin fillor, gjithashtu edhe me të gjithë institucionet e tjera që kanë interes të përbashkët. Kontrolli shëndetësor i nxënësve, kontrolli stomatologjik si dhe kontrolli sanitar i mësimdhënësve kryhet në mënyrë të rregullt nga Qendra Shëndetësore-Dibër. Kontrolli i fundit u realizua në fund të muajit tetor dhe nëntor.

2.2 Seminare dhe trajnime:

Në periudhën para dhe gjatë gjysëmvjetorit të dytë të këtij viti shkollor arsimtarët morrën pjesë aktive në disa seminare/punëtori dhe aktivitete të cilat do t’i paraqesim në mënyrë tabelare në tabelën në vijim

Nr.	Seminare, trajnime dhe punëtori Tema	Vendi i realizimit	Organizoi	Data e realizimit	Pjesëmarës
1	Ministria e Arsimit dhe Shkencës ju informon se më (e premte), do të mbahet një trajnim i shkurtër në lidhje me ESARUED.	Online	BZHA	24.10.2025	Cikli i Ulët Klasët VI-IX
2	Seminar “Aftësi për adoleshencë“	SHFK “Ismail Qemali“ - Gostivar.	BZHA	11,12.11.2025	Mahmud Marke,Qamile Sadrija ,Rajmonda Piperku,Fatjona Pjeça
3	Takim informues rajonal lidhur me kushtet dhe kriteret e reja për dhënien e granteve për promovimin e multikulturalizmit/interkulturalizmit dhe integrimit ndëretnik në shkolla,	Hotel "Merkur" - Tetovë, duke filluar nga ora 10:00.	MASH	19.11.2025	Drejtori
4	Punëtori për bashkëpunëtorët profesional	Ohër	MASH	11.2025	Fatjona Pjeça- Daut
5	Trajnime për mirëmbajtjen dhe modernizimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (ИСУЧР),	Shkup	Министерство за јавна администрација	26.11.2025 08.10.2025	Sekretari Administratori (HRMIS).
6	Trajnim për modulin e **dëftesës elektronike në E-Ditar**	Online	MASH	05.06.2026	Administratorët dhe kujdestarët e klasave të paraleleve nga klasa I deri në klasën III
7	Trajnime për planifikimin dhe realizimin e mësimit në përputhje me programin e ri mësimor për klasën VIII	Online	BZHA	20.06.2026-04.07.2026	Arsimtarët e Klasëve të VIII

Të vetëdijshëm se pjesa e rezultatit dhe suksesit të procesit edukativo- arsimor varet nga niveli profesional i mësimdhënësve, ekipi drejtues i shkollës vazhdimisht obligon mësimdhënësit për vetëvlerësimin e punës së tyre.E gjitha kjo bëhet me qëllimin e qartë që shkolla dhe procesi mësimor të jenë në hap me kohën. Rëndësi e posaçme i kushtohet përdorimit të TIK-ut gjatë mësimdhënies, mënyrës aktive dhe interaktive të zhvillimit të procesit mësimor, përdorimit të mjeteve didaktike, digjitale dhe softuerëve mësimor me qëllim të demostrimit dhe lidhjes së praktikës me teorinë. Bashkëpunimi dhe puna në ekip kanë një peshë të veçantë, pasi aty dalin në pah sfidat, inkurajimi dhe motivimi i arsimtarëve.

2.3 Institucioni ynë arsimor përveç realizimit të plan-programeve mësimore obligative realizon edhe aktivitete jashtë mësimore me nxënës, si:

- Përpilim i Raportit vjetor 2025-2026(ekipi: Rajmonda, Drejtoria)
- Përpilim i Programit për 2026-2027(drejtoria)
- Takime të aktiveve profesional -çdo muaj (kl-VI-IX)
- Shpërndarja e teksteve shkollore I-IX për v.sh. 2025-2026.
- Mbledhje për ndarjen e orëve Këshilli arsimtarëve (dy ciklet). Caktimi i kujdestarëve 2025/2026.
- Të gjithë mësimdhënësit kanë patur mundësi për të ndjekur uebinar-e të rekomanduara nga BZHA.
- Dezinfektim i hapesirave dhe Bris i te gjith te punesuarve Gusht-Shtator 2025.
- Rregullim dhe sistemim te Internetit ne shkolle.
- Porositje e materialeve per kl.1 dhe 4 dhe 5,6 sipas Konceptit te ri te arsimit fillor.
- Dekorim dhe zbukurim i hyrjes së shkollës me rastin e festës së Vitit të Ri-2026 nga gjenerata e klasëve të V-ta nën koordinimin e arsimtareve të tyre.
- Takime me aktivet për përfundim të suksesit në gjysmëvjetor 2025/2026.
- Aktivitete për fillimin e gj.v.dytë,mblëdhje me aktivet profesionale dhe këshillin e arsimtarëve.
- Dezinfektim i hapësirave të shkollës Janar 2026.
- Pergaditje për 7 marsin Patronatin, me aktivitete.
- Shëtitje një ditore sipas planit për ekskursione me nxënesit e klasëve të III,VI,IX.

2.4. Donatorët që kontribuan gjatë vitit shkollor 2025/2026


- Donator për Ushqim (kifle) tek klasët e para
- Donator për ushqim kifle tek klasët e II-V(nxenesit me gjendje me te rënduar sociale 90 nxënes) gjat gjith vititi 2025/2026 me donator Anonim nga SHBA.
- Donacion Pako (qese) klaset I-V.
- Lyerje ngjyrosje e ambienteve te shkolles nga nxenesit.
- Donacion Azem Ballanca Rruga e garave Matematik .
- Ndihmë finansiare nga Komuna Dibër (565000)


2.5 Aspekti infrastrukturor dhe mirëmbajtja e objektit shkollor


Është Drejtoria e shkollës ajo që përdor informacionet e mbledhura për të përgatitur vlerësimet vjetore, pasi mirëmbajtja e objektit varet kryesisht nga buxheti i shkollës dhe njëkohësisht ndihmës së donatorëve. Infrastruktura e duhur dhe mirëmbajtja e shkollës, janë prioritete të rëndësishme të shkollës "Said Najdeni"-Dibër. Për këtë arsye egziston edhe një program i posaçëm i mirëmbajtjes së shkollës, i cili mbështetet në tre përbërës bazë: organizimi, inspektimi dhe plani i mirëmbajtes. Për më tepër, drejtoria udhëzon personelin gjatë përgatitjes së detajuar të zonave, hapësirave, mjeteve dhe pajisjeve që duhet të mirëmbahen.

Për arsye të situatës së pandemisë është rritur kujdesi ndaj masave higjeno-sanitare duke u bazuar në standardet, protokollet dhe normat ligjore në fuqi.

Objektivi ynë kryesor është siguria nxënësve, sidomos kur bëhet fjalë për situate emergjente. Shkolla ka planifikuar planin e evakuimit në raste të jashtëzakonshme.










3.1 Analizë e rezultateve dhe suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor 2025/2026 në shkollën tonë

Rezultatet e larta dhe suksesi i nxënësve është synimi kryesor i shkollës "Said Najdeni". Para se të arrijmë te rezultatet në mësime të nxënësve tanë, fillimisht po paraqesim në mënyrë grafike të dhënat për numrin e nxënësve në fund të vitit shkollor 2025/2026 sipas cikleve dhe në nivel shkolle.








Me grafik janë paraqitur numri i përgjithshëm i nxënësve, numri i nxënësve sipas cikleve dhe numri nxënësve sipas nacionalitetit dhe gjinisë për vitin shkollor 2025/2026 tek cikli i ulët gjegjësisht nga klasa e I deri V dhe cikli i lartë VI-IX. Të dhënat janë marrë nga pasqyrat statistikore që i kanë dorëzuar udhëheqësit e klasëve (kujdestarët) e ciklit të ulët. Të njejtat janë përpunuar në mënyrë elektronike (në excel) nga arsimtarja e Informatikës Rajmonda Piperku.


3.2 Analizë e pasqyrave statistikore që lidhen me suksesin e nxënësve, rregullshmërinë, notat mesatare sipas lëndëve etj, të cilat janë paraqitur me grafik/tabela por edhe me sqarime të shkurtra

Në bazë të analizave të rezultateve dhe suksesit të nxënësve të shkollës sonë si dhe arritjet e nxënësve në përvetësimin e plan-programeve mësimore të vitit shkollor 2025/2026 duke iu referuar statistikave në nivel të paraleleve, gjeneratave (klasave) cikleve dhe në nivel të shkollës do të kemi pasqyrën që do ta paraqesim në vijim përmes numrave dhe grafikëve të përpunuar në mënyrë kompjuterike si dhe me sqarime adekuate.

Nxënësit nga klasa e I-rë deri në kasën e III-të janë vlerësuar me notim përshkrues dhe raportet e udhëheqësve të paraleleve tregojnë që nxënësit e këtyre klasëve kanë përvetësuar me sukses plan-programet mësimore nga të gjitha lëndët mësimore në vitin shkollor 2025/2026.



Në grafikun e mësipërm është paraqitur nota mesatare në nivel të secilës klasë në shkollë duke filluar nga klasa e IV-të deri në të IX-të (notim me numra). Siç mund të vërejmë edhe nga të dhënat, mund të konstatojmë që nota mesatare e klasëve varion nga 3,11 deri në 5,00 që do të thotë se suksesi i nxënësve është solid për çdo klasë, por përpjekje, angazhim maksimal i mësimdhënësve për përmirësimin e të arriturave do të jetë prioritet në vitin e ardhshëm shkollor.




Ndërsa në grafikun e paraqitur më lart, janë të dhënat nga sumimi i notave mesatare në nivel gjenerate gjegjësisht nga gjeneratat e nxënësve të klasës IV - IX ku notimi është me numra. Notat mesatare sipas gjeneratave paraqiten me notë mesatare mbi 3,78 që me vitin e kaluar shkollor ka pak dallim në rritje të suksesit. Në vitin e ardhshëm shkollor fokusi do të jetë bashkëpunimi dhe angazhimi maksimal mes nxënësve dhe mësimdhënësve për arritje më të larta tek nxënësit në procesin edukativo-arsimor. Ekipi drejtues i shkollës bën përpjekje që notimi i nxënësve të jetë sa më objektiv dhe real me qëllim që edhe nxënësit të kenë vlerësimin e tyre për vitet vijuese, por edhe për të vendosur synimet e arritjeve në procesin edukativo-arsimor në periudhën që vijon.


Sipas të dhënave të përpunuara në grafik nota mesatare sipas gjeneratave është:

- Klasa e IV -rt me notë mesatare 4,32
- Klasa e V -të me notë mesatare 4,33
- Klasa e VI -të me notë mesatare 4,03
- Klasa e VII -të me notë mesatare 3,78
- Klasa e VIII -të me notë mesatare 3,78
- Klasa e IX -të me notë mesatare 3,82
- Në nivel shkolle, nota mesatare është 4,07.

Nota mesatare në nivel të cikleve dhe në nivel shkollor për vitin shkollor 2025/26 është e paraqitur në grafikun në vijim:



Në grafikun në vijim janë të dhënat e notës mesatare sipas lëndëve nga klasa IV – IX.




Sipas të dhënave në grafik, ku notimi është me numra, gjegjësisht nga klasa IV - IX, nota mesatare më e lartë sipas lëndëve është në lëndët në vijim:

- Arsim fizik dhe shëndetsor me notë mesatare 4,56
- Projekte nga informatika me notë mesatare 4,44
- Arsim teknik dhe informatikë - moduli arsim teknik me notë mesatare 4,40.

Duke e analizuar grafikun e të dhënave për notat mesatare sipas lëndëve rezulton se nota mesatare pak më e ulët është tek lëndët:

- Gjuhë maqedone me notë mesatare 3,49
- Gjeografi me notë mesatare 3,49
- Kimi me note mesatare 3,50.



Në grafik janë paraqitur të dhënat e përmbëledhura të mungesave të nxënësve në nivel të ciklit të ulët gjegjësisht nga klasa e I-parë deri tek klasa e V-pestë, për ciklin e lartë nga klasa e VI deri të IX si dhe në nivel shkolle kl. I-IX. Siç mund edhe të vërehet tek tabela, në nivel cikli për vitin shkollor 2025/2026 te cikli i ulët janë bërë gjithsej 96 mungesa prej të cilave 59 me arsye dhe 37 paarsye. Tek cikli i lartë numri i përgjithshëm i mungesave të nxënësve për vitin shkollor 2025/2026 është 1329, prej të cilave 877 me arsye dhe 452 paarsye. Në nivel shkolle shënohen gjithësejt 1425 mungesa, 936 prej të cilave me arsye dhe 489 pa arsye.

Drejtoria përgatiti dhe përpiloi planin aksional në të cilin u parashikuan mbledhjet e aktiveve profesionale gjatë muajit qershor-2026 në planin operativ për mbarimin e vitit shkollor 2025/2026, që u arkivua në arkivin e shkollës , të cilin po ashtu e publikoi në formë të shkruar, por edhe e shpërndau edhe në formë elektronike tek të gjithë mësimdhënësit dhe shërbimet e shkollës.

Puna e aktiveve vazhdoi edhe gjatë muajit gusht. Me synim, mbajtjen e trendit të angazhimit të të gjitha resurseve njerëzore në shkollë, që kanë si qëllim përmirësimin e rezultateve të nxënësve në vazhdimësi, në takime të veçanta të aktiveve që u realizuan në javën e dytë të muajit gusht 2026, u diskutuan të gjitha problematikat që lidhen me procesin edukativo arsimor në shkollë, me punën e drejtëpërdrejtë të mësimdhënësve me nxënësit. Në këto mbledhje të gjithë anëtarët e aktiveve diskutuan dhe dhanë sugjerime e propozime për përmirësimin dhe rritjen e rezultateve tek të dy ciklet, gjegjësisht prej klasës I – V dhe VI-IX. Disa nga konkluzat që dolën nga këto mbeledhje janë:

- Bashkëpunim i vazhdueshëm me prindërit me qëllim për arritje më të suksesshme me nxënësit.
- Angazhim maksimal në motivim të nxënësve në aspektin edukativo-arsimor dhe arritje të rezultateve më të larta me të gjithë nxënësit për vitin shkollor 2026/2027.
- Krijim i orëve mësimore më interaktive duke përdorur aplikacione dhe përmbajtje digjitale të ndryshme në mësimin dhe përdorim të softuerëve arsimor interaktiv.
- Metoda dhe teknika të ndryshme me nxënësit të cilëve ju mungon ndihma në detyrat dhe angazhimet e tjera mësimore nga ana e prindërve në shtëpi për arsye të ndryshme.
- Bashkëpunim me aktivet e tjera, shërbimin pedagogjik, për të këmbyer përvoja të reja në punën që veprojmë dhe për të pasur më shumë sukses me nxënësit, prindërit dhe me veten tonë.

Duke u bazuar në këto propozime dhe konkluzione, drejtoria përpiloi aktivitete të obligueshme për realizim deri në fund të këtij viti shkollor, të cilat kanë si synim arritjen e rezultateve sa më të larta si në aspektin edukativ, ashtu edhe në atë arsimor.

Pritshmëritë e dala nga këto takime kanë të bëjnë me rritjen e angazhimit dhe aktiviteteve nga shërbimi professional, rritjen po ashtu të nivelit dhe intensitetit të komunikimit mes shërbimit profesional me aktivet, duke organizuar trajnime, puntori dhe shkëmbim përvojash, ku do t'u jepen këshilla dhe instruksioneve të gjithë mësimdhënësve të shkollës për punë më të suksesshme me nxënësit.

Procesin edukativo-arsimor në ciklin e lartë (I – V) në fund të vitit shkollor 2025/2026 e përcjellin gjithsej 190 nxënës. Suksesi, gjegjësisht arritjet e nxënësve sipas klasëve (gjeneratave) do të paraqiten me sa vijon:

Paralelet e klasës së I-rë numërojnë gjithsejt 35 nxënës. Notimi i tyre është me përshkrim dhe sipas raporteve të kujdestareve të klasëve përkatëse arritjet e tyre janë solide. Nënësit e kësaj gjenerate kanë shënuar gjithsejt 16 mungesa mungesa të cilat janë mungesa me arsye për këtë vit shkollor.

Paralelet e klasës së II-të numërojnë gjithsejt 30 nxënës. Notimi i tyre është me përshkrim dhe sipas raporteve të kujdestareve të klasëve përkatëse arritjet e tyre janë solide. Nënësit e kësaj gjenerate nuk kanë shënuar mungesa për këtë vit shkollor.

Paralelet e klasës së III-të numërojnë gjithsejt 46 nxënës. Notimi i tyre është me përshkrim dhe sipas raporteve të kujdestareve të klasëve përkatëse arritjet e tyre janë solide. Nënësit e kësaj gjenerate nuk kanë shënuar mungesa për këtë vit shkollor.

Paralelet e klasës së IV-rt numërojnë gjithsejt 31 nxënës. Notimi i nxënësve të klasëve të katërta sipas arritjeve të tyre për vitin shkollor 2025/2026 arrin notën mesatare 4,32. Nxënësit e kësaj gjenerate nuk kanë shënuar mungesa për këtë vit shkollor.

Paralelet e klasës së V-të numërojnë gjithsejt 45 nxënës. Arritjet e nxënësve në përvetësimin e plan-programeve mësimore për vitin shkollor 2025/2026 paraqitet me notën mesatare 4,33. Nxënësit e gjeneratës së klasës së pestë për këtë vit shkollor kanë shënuar mungesa 80, prej tyre 43 me arsye dhe 37 paarsye.

.

Procesin edukativo-arsimor në ciklin e lartë (VI – IX) në fund të vitit shkollor 2025/2026 e përcjellin gjithsej 200 nxënës. Suksesi, gjegjësisht arritjet e nxënësve sipas klasëve (gjeneratave) do të paraqiten me sa vijon:

Paralelet e klasës së VI-gjashtë numërojnë gjithsejt 41 nxënës. Notimi i nxënësve të klasëve të gjashta sipas arritjeve të tyre për vitin shkollor 2025/2026 arrin notën mesatare 4,03. Nxënësit e kësaj gjenerate kanë shënuar gjithsejt 28 mungesa, prej tyre 21 me arsye dhe 7 paasrsye.

Paralelet e klasës së VII-shtatë numërojnë gjithsejt 39 nxënës. Arritjet e nxënësve në përvetësimin e plan-programeve mësimore për gjysëmvjetorin e parë të vitit shkollor 2025/2026 paraqitet me notën mesatare 3,78. Nxënësit e gjeneratës së klasës së shtatë kanë shënuar gjithsejt 213 mungesa, 139 me arsye dhe 74 paarsye.

Paralelet e klasës së VIII-tetë kanë gjithsejt 49 nxënës. Nxënësit e kësaj gjenerate në procesin mësimor për këtë gjysëmvjetor, arritjet e tyre i kanë pasqyruar përmes

notës mesatare të përgjithshme 3,78. Nga kjo gjeneratë janë shënuar gjithsej 340 mungesa, prej të cilave mungesa të arsyeshme 187 dhe mungesa të paarsyeshme 153.

Procesin mësimor në klasën e IX-nëntë e vijojnë gjithsej 45 nxënës. Nota mesatare e paraleleve të klasës së nëntë, që edhe e pasqyron suksesin në procesin mësimor është 3,82. Nga kjo gjeneratë janë shënuar gjithsej 748 mungesa, prej të cilave mungesa të arsyeshme 530 dhe mungesa të paarsyeshme 218.

Nëse bëjmë krahasimin e suksesit të nxënësve në fund të vitit shkollor 2025/2026 me fundvitin e vitit shkollor 2024/2025 na rezulton se notat mesatare në nivel ciklesh kanë shumë pak dallim, ka rritje te suksesit, ndërsa numri i mungesavë është dukshëm më i ulët. Suksesi si faktor mund të përmendim ngritjen e kriteriumit për vlerësim, arsimtarët e sapo punësuar si dhe qëllimi kryesor ka qenë që të bëhet vlerësim sa më real dhe korrekt, si dhe vështirësitë që hasen gjatë mësimit.

Pas mbylljes të këtij viti shkollor, synimi kryesor i shkollës sonë është rritja e suksesit dhe rezultateve të nxënësve në të gjitha lëndët në vitin e ardhshëm shkollor. Prandaj shkolla jonë po shfrytëzon të gjitha mekanizmat që ndihmojnë në këtë proces. Kështu, në mbledhjen e Këshillit të Arsimtarëve, që sipas planit vjetor u mbajt në javën e tretë të muajit qershor 2026, duke u bazuar te raportet e paraqitura nga të gjithë kujdestarët e klasave, nga klasa e I-rë deri në klasat e IX-ta u diskutuan detajisht të gjithë aspektet e procesit edukativo-arsimor. Mbledhja në fjalë doli edhe me konkluzione të qarta për aktivitetet që do të realizohen në vitin shkollor 2026/2026. Lista e këtyre aktiviteteve u miratua me shumicë votash nga Këshilli i Arsmimtarëve. Më pas, në Këshillin e Shkollës u diskutuan të njëjtat konkluzione të sjella nga Këshilli i Arsimtarëve, konkluzione këto që u pranuan njëzëri nga antarët e Këshillit të Shkollës.

Për të përcjellë nga afër dhe më detajisht realizimin e programit vjetor të punës së shkollës në vitin shkollor 2025/2026, drejtori i shkollës formoi një ekip të posaçëm, së cilit iu ndanë detyra që të mbikqyrë realizimin e këtij programi. Ekipi ka për detyrë që të ndjekë nga afër dhe të mbajë shënime të detajuara për të gjitha aktivitetet dhe procesin e punës dhe më pas, në fund të vitit shkollor të përgadisë raportin për punën e përgjithshme të shkollës për fundvitin shkollor 2025/2026. Ky ekip ka konstatuar se deri në përgatitjen e këtij raporti, të gjitha aktivitetet janë realizuar sipas programit vjetor për punë të shkollës, në përputhje edhe me programin zhvillimor 4-vjeçar të propozuar nga drejtori dhe miratuar nga Këshilli i shkollës.

Sh.F.K. “Said Najdeni” – Dibër

Miratuan

Këshilli i shkollës
Kryetar
Lumi Croj

_____
(nënshkrimi)

Drejtor
Arsim Miftari

_____
(vula dhe nënshkrimi)

Raportin e përgaditën
Ekipi:Koordinator dhe Përpunimi kompjuterik: Rajmonda P./Drejtoria
Përkthimi në Maqedonisht – Drejtoria
Anëtar: Arjeta K., Laura H., Sanije A.

Dorëzuar deri tek:
-Arkivi i shkollës
-Tabela e shpalljeve (shpallur ne ueb faqe)
-Posta elektronike e mësimdhënësve
-Këshilli i shkollës
-ISHA-Dibër

Dibër, Gusht 2026